



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 01.04.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Spartak Braho, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Silva Caka, Nard Ndoka, Oerd Bylykbashi, Armando Prenga, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Xhemal Qefalia, Fatmir Mediu, Dashamir Peza, Mark Frroku, Vexhi Muçmataj, Eduard Halimi.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Ermonela Felaj, Tom Doshi, Vasilika Hysi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Edi Paloka, Tahir Muhedini, Mhill Fufi dhe Gjovalin Bzheta.

Të ftuar:

Ervin Mete – zëvendësministër i Financave

Arjana Dyrmishi – drejtoreshë e Politikave Fiskale dhe Marrëdhënieve Ndërqeveritare në Ministrinë e Financave

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi!

Meqenëse kuorumi është realizuar mund të hapim mbledhjen e komisionit, e cila sot në rend dite ka projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

Nga Ministria e Financave është zëvendësministri i Financave zoti Ervin Mete dhe zonja Arjana Dyrmishi, drejtoreshë në Drejtorinë e Politikave Fiskale dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Ministrinë e Financave. Relator është zoti Fino.

Fillimisht do të dëgjojmë ekspozenë e përfaqësuesve të qeverisë në mbështetje të projektit. Po, zoti Mete.

Ervin Mete – Faleminderit, zoti kryetar!

Ndryshimi që paraqitet për miratim ka të bëjë me një rregullim specifik për borxhet ose kreditë e këqija të bankave. Rregulli aktual fiskal është që praktikisht për të njohur si shpenzim të zbritshëm një borxh të keq, duhet që të jenë ezauruar të gjitha mjetet ligjore, çka do të thotë duhet të ketë kaluar në gjykatë dhe fazën e përmbarimit ose ekzekutimit të detyrueshëm. Siç e dimë, mund të marrë një kohë të gjatë shpeshherë dhe me vite. Duke pasur parasysh gjendjen e sektorit, duke pasur parasysh shifrën e lartë të kredive të këqija që sot kanë bankat, në masën 23,5%-24%, në kuadrin e një sërë masave të dakordësuara dhe me Bankën Botërore dhe të rëna dakord unanimisht dhe me sektorin e bankave, paraqesim këtë ndryshim, i cili specifikisht veçon sektorin e bankave në trajtimin fiskal të borxheve të këqija duke vendosur rregullin që një borxh i keq për bankat, pra një kredi e keqe do të mund të nxirret jashtë bilancit dhe të njihet si shpenzim i zbritshëm nga ana fiskale pas 365 ditësh. Pra, pas një viti nga momenti që është lëshuar urdhri i ekzekutimit ose nga momenti që ka nisur ekzekutimi i detyrueshëm ne do të konsiderojmë se janë ezauruar të gjitha mjetet ligjore për bankat dhe banka ka mundësi tani fiskalisht që të nxjerrë këto kredi të këqija jashtë bilancit dhe ne t’ia njohim si shpenzim për çështje tatimore ose fiskale. Shpresojmë që, shoqëruar me masat e tjera, ajo e provigjon dhe që ju keni pasur rastin ta shqyrtoni në dhjetor, si dhe udhëzimin e përbashkët që para pak kohësh ministri i Financave e ka nxjerrë me ministrin e Drejtësisë lidhur me përmbarimin. Ky set masash besojmë që jo vetëm do të ndihmojë bankat që të përmirësojnë treguesit e tyre të performancës, por nga ana tjetër dhe të çlirojnë më tepër kredi në ekonomi.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Fino.

Bashkim Fino – Thjesht është pastrim i bilanceve të bankave.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje? Po, zoti Islami.

Kastriot Islami – Sa është shuma e të gjitha këtyre kredive të këqija?

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Mete.

Ervin Mete – Shifra në dhjetor të vitit 2013 ka qenë 23,5%, sipas Bankës së Shqipërisë, ose rreth 133 miliardë lekë.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Islami.

Kastriot Islami – Në qoftë se këta nuk paguajnë këtë detyrim fiskal, i bie 10% e kësaj shume apo 20%.

Ervin Mete – 6%.

Kastriot Islami – Domethënë në qoftë se këta shmangen nga detyrimi që ju keni propozuar?

Ervin Mete - Po jua sqaroj për të mos pasur konfuzion. Ajo që ndodh është praktikisht banka nuk mund ta konsiderojë si shpenzim të zbritshëm fiskal. Pra, nuk po flasim për bilancet e veta që ajo mban për performancën e vet, por si shpenzim të vetin fiskal sipas rregullit që ne sot kemi në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” nuk mund ta konsideroj në qoftë se nuk ezauron të gjitha shkallët ligjore dhe përmbarimin ose ekzekutimin e detyrueshëm. Më këtë rast ne i themi që pas një viti mund ta konsideroj si shpenzim të zbritshëm. Ajo që ndodh është që del jashtë bilancit dhe në qoftë se rikthehet, pra nuk fshihet, nuk falet. Banka vazhdon ta ndjekë. Por në qoftë se rikthehet për ne është një e ardhur shtesë dhe përsëri e tatueshme. Pra, nuk i shpëton rrjetës fiskale.

Bashkim Fino – Janë 24% të borxheve... *(flet pa mikrofon)*

Ervin Mete – Kjo u takon bankave, por ne nga ana jonë japim incentivë që ata të mund ta kryejnë si veprim. Pastaj kjo i takon vendimmarrjes më të lartë të bankave. Domethënë, vendimmarrja për të kaluar një kredi të keqe jashtë bilancit u takon vendimmarrësve më të lartë të tyre, pra bordeve. Ne u japim incentivën fiskale për ta bërë këtë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje të tjera, se kjo puna e kredive të këqija është paksa e ngatërruar?...

Po, zoti Frroku.

Mark Frroku – Do të isha shumë dakord me këtë iniciativë, por ne do të ndërmarrim edhe një iniciativë tjetër, sepse bankat në Shqipëri kanë një normë interesi jashtëzakonisht të lartë, që vjen duke u rritur vit për vit. Është një llogari shumë e thjeshtë: edhe në fund të shlyerjes së detyrimit ose të kredisë njerëzit arrijnë të paguajnë deri në 16%-17% dhe kjo nuk më duket marrje kredie, por fajde. Bankat janë kthyer në fajdexhinj dhe kjo gjë asfikson në maksimum si biznesin e vogël, si atë të madh. Duhet ta shikojnë edhe këtë pjesë.

Fatmir Xhafaj – Nuk kishit pyetje?

Mark Frroku – Jo.

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje të tjera? Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Zëvendësministër, kam një pyetje, e mora spuntin nga përgjigjja që dhatë më parë. Ju thoni se po krijoni incentivën për bankat për të kryer këtë veprim. Nëse qeveria po jep incentivë, do të thotë që ka interes qeveria ta bëjë.

Pra desha të di, sepse nga relacioni nuk del e qartë, është qeveria që kërkon ta bëjë këtë dhe, nëse kërkon ta bëjë me iniciativën e saj, a është konsultuar edhe me sistemin bankar, apo janë bankat që po ia kërkojnë këtë qeverisë?

Edhe një pyetje të dytë, ndoshta jo drejtpërdrejt me çfarë është propozuar këtu, por që ka të bëjë me kreditë e këqija: A gjykoni ju se do të ketë rritje të kredive të këqija, për shkak se një numër i lartë i punonjësve të administratës, që mund të kenë marrë kredi, po lënë sot vendet e punës në mënyrë edhe të kundërligjshme? Pra, a keni ndonjë pritshmëri në lidhje me këtë?

Faleminderit!

(Diskutime në sallë.)

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zoti Mete për të dyja pyetjet.

(Deputeti Mediu flet pa mikrofon.)

Zoti Mediu, ju lutem!

Ervin Mete – Për sa i përket pjesës së konsultimit, është konsultuar gjerësisht me bankat, është pranuar formulimi ekzakt në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët e Shoqatës së Bankave, është rënë dakord me Bankën Botërore dhe me Bankën e Shqipërisë. Pra, të gjithë aktorët kryesorë të tregut financiar janë dakord që është një masë e nevojshme.

Oerd Bylykbashi – Pyetja ishte tjetër: është propozim i qeverisë, apo vjen nga bankat?

Ervin Mete – Është propozim i qeverisë i dakordësuar me bankat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, kolegë!

Ervin Mete – Për pyetjen që ju adresuat se sa mund të jetë masa e kredive, nuk kam informacion, si dhe do ta rezervoja përgjigjen për një kohë të dytë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti zëvendësministër, për përgjigjet!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Diskutime për kreditë e këqija dhe administratorët e këqij të bankave? Nuk ka.

Atëherë, kush është dakord në parim? Dakord. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Dakord. Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit! E mbylлим për sot këtë mbledhje.

Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Faleminderit, zonja drejtoreshë që ishit prezent!

Nesër në orën 10:00 është projektligji “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”.